

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 1 prej 12
		Versioni	1.0

# Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve

2024

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 2 prej 12
		Versioni	1.0

## Përbajtja

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>2. BAZA LIGJORE.....</b>	<b>4</b>
<b>3. PLANI PËR ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE NË VITIN 2024 .....</b>	<b>5</b>
<b>3.1 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE DHE PRITSHMËRIA NË ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE .....</b>	<b>5</b>
<b>3.2. KALKULIMI I HUMBJEVE TEKNIKE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES DHE METODOLOGJIA E APLIKUAR .....</b>	<b>6</b>
<b>4. PLANI .....</b>	<b>8</b>
<b>5. PËRFUNDIM .....</b>	<b>12</b>
<b>6. SHTOJCË.....</b>	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>6.1. PROJEKTET NË TENSION TË ULTË .....</b>	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>6.2. PROJEKTET NË TENSION TË MESËM .....</b>	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>6.3 PËRMIRËSIMET OPERATIVE .....</b>	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>6.4 VJETËRSIA E NJEHSORËVE DHE SYNIMET PËR NDËRRIMIN E TYRE.....</b>	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 3 prej 12
		Versioni	1.0

## 1. HYRJE

Në sistemet energjetike me humbje u referohemi dallimeve të energjisë elektrike të futur në sistem dhe energjisë së faturuar tek konsumatorët fundor, respektivisht është sasia e energjisë elektrike e injektuar në rrjet e cila konsumohet por nuk u faturohet nga konsumatorëve fundor. Humbjet totale përbehen nga dy komponentë, humbjet teknike dhe humbjet jo-teknike (humbjet komerciale). Humbjet teknike ndodhin natyrshëm gjatë kalimit të energjisë elektrike nëpër elementet e sistemit siç janë linjet e shpërndarjes, transformatorët dhe sistemet matëse. Ndërsa humbjet komerciale shkaktohen nga veprimet e shkaktuara në sistemin energjetik si: ndërhyrjet në pikën matëse ose në anashkalimin e pikës matëse dhe përbëhen kryesisht nga vjedhjet e energjisë elektrike, etj. Këto kategori të humbjeve cilëson ndryshe edhe si humbje komerciale.

Optimizmi i humbjeve teknike në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike është problem inxhinierie që përfshin metodat klasike të planifikimit dhe modelimit të sistemit. Qëllimi dhe kriteri bazë i planifikimit dhe modelimit të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike është minimizimi i vlerës neto aktuale i kostove të investimeve plus kostove të humbjeve teknike.

Humbjet teknike përfaqësojnë gjithashtu një humbje ekonomike përvendin, prandaj optimizmi i tyre duhet parë nga perspektiva shtetërore pavarësisht organizimit institucional të sektorit dhe pronësisë së operatorëve të energjisë elektrike.

Humbjet jo teknike përfaqësojnë një humbje të shhangshme financiare përvendorin e shpërndarjes së energjisë elektrike në qoftë se legjislacioni dhe institucionet përkatëse mbështesin atë në veprimet përluftimin dhe eliminimin e humbjeve jo teknike. Është e qartë se shuma e energjisë elektrike e përfshirë në humbjet jo teknike konsumohet nga përdoruesit e nuk faturohet prandaj edhe nuk paguajnë përvjetore gjë të tillë. Eksperienca tregon se një përqindje e konsiderueshme e kësaj energjie elektrike ulë kërkësën kur nga përdoruesit kërkohet që të paguajnë përvjetore energji elektrike, sepse ata e rregullojnë konsumin e energjisë elektrike në bazë te aftësisë së tyre përvjetore që të paguar atë. Prandaj ulja e kërkësë përvjetore energji ka saktësishët të njëjtin efekt që ka zvogëlimi i humbjeve teknike, dhe më pak kërkësë përvjetore gjenerimin dhe sigurimin e energjisë elektrike. Kështu që nga perspektiva e vendit gjithashtu zvogëlimi dhe eliminimi i humbjeve jo teknike është shumë pozitive.

Nga pikëpamja sociale humbjet jo teknike kanë një efekt shumë të keq. Ka një gamë të gjerë të situatave që krijojnë humbjet jo teknike. Rastet klasike janë vjedhjet e energjisë elektrike nga lidhjet e paautorizuara

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 4 prej 12
		Versioni	1.0

dhe manipulimet e sistemeve matëse. Është e qartë që këto veprime përbejnë vepra penale që ndiqen në bazë të ligjeve në fuqi, por në rastet kur operatorët nuk kanë mbështetje të mjaftueshme të kornizës rregullative dhe sistemi i drejtësisë vepron shumë ngadalë, atëherë operatorët e kanë shumë të vështirë për të eliminuar efektin e keq social dhe ekonomik që shkaktojnë humbjet jo teknike.

Zvogëlimi i humbjeve teknike është rezultat i investimeve të mëdha kapitale dhe mirëmbajtjes adekuate të sistemit te shpërndarjes. Investimet kapitale kërkojnë analizë dhe diagozë të thellë të sistemit, identifikim të gjendjes aktuale, përcaktimin e zonave më problematike, analizën e kostos dhe përfitimit, etj.

Me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike Operatori i Sistemit te Shpërndarjes (KEDS) ka përpiluar planet e investimeve afatmesëm dhe afatgjatë, respektivisht planin investiv nje-vjecar, 5-vjecar dhe ate zhvillimor 10-vjecar, te cilat janë dërguar ne rregulator per aprovim. Keto plan gjithëpërfshirës përbën gjithashtu strategjinë e KEDS-it në lidhje me zvogëlimin e humbjeve teknike.

Zvogëlimi i humbjeve jo teknike ose me fjale të tjera humbjeve komerciale është rezultat i organizimit të mirë të ekipeve për inspektim dhe kontrollim të sistemeve matëse, gjithashtu edhe përdorimi i teknologjive moderne të cilat mund të kontribuojnë në parandalimin e vjedhjeve te energjisë elektrike përmes manipulimit të sistemeve matëse, veprimeve adekuate te organeve shtetërore, siç janë gjykatat dhe ato te monitorimit te zbatimit te ligjit.

## 2. BAZA LIGJORE

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (në vijim, OSSH) ka përgatitur planin vjetor të humbjeve per vitin 2024 ashtu siç kërcohët me dispozitat e nenit 28, paragrafi 1.24 dhe 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike si dhe nenit 14.2 të Licencës së OSSh-së, me numër të licencës ZRRE/Li/Tr\_06/17.

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 5 prej 12
		Versioni	1.0

### 3. PLANI PËR ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE NË VITIN 2024

OSSH-ja vitin 2023 parashevë të përfundon me 15.31% humbje totale bazuar në realizmin deri në Tetor 2023 dhe parashikimin përmes muajt Nëntor, Dhjetor nga Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike, aprovuar nga ZRRE përmes vitin 2023.

OSSH-ja përmes vitit 2024 synon qe humbjet totale te jene 14.70 %, sipas kërkuesës qe rrjedh nga vendimi V\_1636\_2022 përmes Cakun e Reduktimit te Humbjeve dhe Lakoren e Humbjeve te Lejuara per Periudhën e Tretë Rregullative. Përmes tij arritur cakun OSSH-ja do të përqendrohet në investimet kapitale përmes zvogëlimin e humbjeve teknike dhe optimizmin e operimeve përmes tij të luftuar dhe zvogëluar humbjet jo teknike.

Pra deri në fund të 2024, OSSH planifikon që zvogëlimi i humbjeve te jete 0.61 pp, krahasuar me vitin 2023.

#### 3.1 Plani i investimeve kapitale dhe pritshmëria në zvogëlimin e humbjeve

Planet e investimeve do të tentohet të realizohen sipas Planit investiv 1-vjecar te KEDS-it.

Departamenti i Investimeve është duke punuar fuqishëm në zhvillimin e projekteve, sipas prioriteteve duke u bazuar në nivelin dhe kriteret e paracaktuara nga OSSH-ja, e ndërtojë edhe një nivel i humbjeve në lokalitetet apo TS-ët përkatëse. Po ashtu Departamenti i Mirëmbajtjes është duke punuar në rrjetin e tensionit të mesëm (në disa projekte të nivelit të tensionit te mesëm) si dhe në disa projekte të tensionit të ultë ku përfshihet rehabilitimi i rrjetit ekzistues, intervenimi në dalje të caktuara 0.4kV, si dhe në verifikimin dhe balancimin e ngarkesave në TS, etj. Këto projekte kanë përmes qëllim eliminimin e rrjetit të vjetër dhe zëvendësimin me rrjet të ri, përmirësimin e kualitetit të tensionit.

Gjatë vitit 2024, OSSH ka orientuar investimet e veta në projektet e nivelit të ultë të tensionit (TU), përgjatë të cilave projekte do të bëhet zëvendësimi i shtyllave, kabllove, trafove, etj., dhe kësidoj do të zvogëlohen ndërprerjet të cilat shkaktohen si rezultat i kushteve jo të mira në TU si dhe në nivelin e tensionit të mesëm TM. Në kuadër të projekteve të planifikuara në TU përmes vitin 2024 janë edhe vendosja e njehsorëve PLC, përmes së cilëve konsumatorët kanë mundësinë që online përmes aplikacioneve softuerike të zhvilluara nga OSSH të shohin konsumin e vet të energjisë elektrike në kohë reale, prandaj kjo mundësi do të ndikoj që konsumatorët të vetëdijesohen në kuptim të shpenzimit racional të energjisë elektrike, si dhe lehtësohen

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 6 prej 12
		Versioni	1.0

dukshëm puna rreth identifikimit të konsumatorëve që keqpërdorin energjinë elektrike. OSSh menaxhon pjesën e rrjetit të Tensionit të Mesëm (TM) përmes projektit të SCADA-s, leximit, shkyçjes, kyçjes dhe shërbimet tjera në TU përmes sistemit PLC. Të gjitha këto ndikojnë drejtpërsëdrejti në performancën e operimeve dhe rrisin eficiencë në këto pjesë. Në tabelën 1 është paraqitur pritshmëria e zvogëlimit të humbjeve përgjatë vittit 2024.

Tabela 1. Pritshmëria e zvogëlimit të humbjeve përgjatë vittit 2024

Plani i investimeve	Qëllimi	Përfitimet e pritshme (pikë përqindje)
Projektet në TU + TM	Më pak ndërprerje të energjisë e elektrike, Njehsorët PLC – Zvogëlim i humbjeve	0.32
Përmirësimet Operative dhe kontrolli i konsumatorëve	Përmirësim në Lexim - Arkëtim, intervenime në kohë reale ndaj ndërprerjeve të energjisë elektrike, Kontrolli e konsumatorëve	0.29

### 3.2. Kalkulimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes dhe metodologja e aplikuar

Përveç llogaritjes së humbjeve teknike të fuqisë, pakoja softuerike “Power Factory” mundëson edhe llogaritjet e humbjeve teknike të energjisë, duke përdorur ‘time sweep’ në kuadër të Power Factory.

Ky softuer përdoret për analizat si në vijim:

Analiza e rrjedhjes së ngarkesës (humbjet teknike me ngarkesë dhe pa ngarkesë, rëniet e tensionit, ngarkesa e linjave, etj).

1. Analiza e lidhjeve të shkurta
2. Analiza e stabilitetit të tensionit
3. Analiza e linjave ajrore dhe kaballore
4. Analiza e rrjetit të shpërndarjes
5. Funksionet e mbrojtjes
6. Analiza e qëndrueshmërisë

Si metodë e llogaritjes së analizave të cekura më lart përdoret rrjedhja e ngarkesës AC, e balancuar, sekuenca pozitive. Ndërsa rrjedhja e ngarkesës bëhet sipas metodave:

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 7 prej 12
		Versioni	1.0

1. Njuton – Rapson (Ekuacionet e rrymave)
2. Njuton – Rapson (Ekuacionet e fuqive, klasike).

OSSH-ja është duke punuar që të ketë rezultate sa më të sakta të humbjeve teknike.

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 8 prej 12
		Versioni	1.0

#### 4. PLANI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE JO TEKNIKE

Organizimi i Departamentit për Humbje te Energjisë Elektrike është si më poshtë.

1. Njësia për kontrollimin e humbjeve,
2. Njësia e AMR & Kalibrim,
3. Njësia për mirëmbajtjen e matjeve gjysmë-indirekte dhe indirekte,
4. Njësia për lidhje të reja (pranimin teknik të lidhjeve të reja) dhe Njësia për Verifikimin e Kodeve,
5. Njësia për pranime teknike sipas PEE.

Departamenti ka staf në të gjitha Distriktet dhe vepron në tërë territorin e mbuluar nga KEDS

Struktura organizative e departamentit sipas distrikteve është e paraqitur ne tabelën 2.

Tabela 2. Struktura e Departamentit të Humbjeve të OSSh-së

Distrikti	Drejtori	Menaxher	Udhëheqës	Koordinator	Inxhinier	Ekspert për kontrollimin e humbjeve	Analist	Teknik për kontrollimin e humbjeve	Teknik i mirëmbajtjes së matjeve	Teknik për lidhje të reja	Përgjegjës për pranimin e njehsorëve	Teknik i kalibrimit	Teknik për verifikimin e kodeve	KEDS Akademi	Total
DFE			3			1	10	4	7			2	2	29	
DGJ			3			1	8	4	7	1			2	26	
DGL			3			1	9	5	5			2		25	
DMI			3			1	12	4	5	1		3	2	31	
DPE			3			1	10	4	6	1		2	1	28	
DPR			3			3	19	7	13	1			1	47	
DPZ			3			1	12	5	6			2	1	30	
HQ	1	1	6	3	17	6	1	4			10	1	4	54	
<b>Total</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>24</b>	<b>17</b>	<b>6</b>	<b>10</b>	<b>80</b>	<b>37</b>	<b>49</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	<b>12</b>	<b>13</b>	<b>270</b>

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 9 prej 12
		Versioni	1.0

Gjatë vitit 2024, Departamenti i Humbjeve ka planifikuar të punojë sipas pikave të poshtëshënuara:

1. Kontrollimi i konsumatorëve sipas daljeve me humbje më të mëdha (*BEE*).
2. Kontrollimi i konsumatorëve sipas listave të përpiluara gjatë leximit të konsumatorëve (*Case Code*).
3. Kontrollimin i konsumatorëve në bazë të veprimtarisë së shtuar sezonale.
4. Kontrollime rutinore të konsumatorëve te “padiciplinuar”.
5. Kontrollimi i konsumatorëve sipas njoftimeve nga qendra e thirrjeve, auditimi, etj.
6. Zhvendosjen e njehsorëve sipas projekteve të investuara (*MMO – PLC - SMART*).
7. MMO të rëndomta, kryesisht te konsumatorët me RH.
8. Ndërrimet e njehsorëve nga mekanik në elektronik.
9. Pranimi teknik i lidhjeve të reja.
10. MC kodet nga leximet me HHU.
11. Informatat e marra nga AMR, shkyçja e konsumatorëve, diagramet vektoriale, etj.
12. Informatat e marra nga Ekipet për verifikimin e kodeve.

Duke u bazuar në pikat e lartshënuara gjatë këtij viti planifikohet të bëhen realizimet ashtu siç është përshkruar në vijim.

Në kontrollimet të cilat do të bëhen në daljet me humbje më të mëdha, nga burimet apo mundesitë tjera konkrete sipas informatave të ndryshme dhe bazuar në kapacitetet e ekipeve që posedojmë, planifikojmë të arrijmë rikthimet e humbjeve në vlerë prej: **13,000 MWh**.

Duke u bazuar nga viti i kaluar në numrin e konsumatorëve të kontrolluar dhe kapacitetet në staf dhe ekipe që posedojmë këtë vit, planifikohet të bëhet kontrollimi dhe inspektimi i konsumatorëve për të gjitha grupet tarifore siç edhe është paraqitur në tabelën 3.

Gjithashtu në tabelën 3 janë paraqitur edhe objektivat për rikthimin e humbjeve jo teknike.

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 10 prej 12
		Versioni	1.0

Tabela 3. Objektivat për kontrollimin e konsumatorëve dhe rikthimin e humbjeve

Muaji	Kontrollimi i konsumatorëve (#)	Rikthimi i humbjeve (MWh)
Janar	7,000	1,000
Shkurt	7,000	1,000
Mars	7,000	2,000
Prill	6,000	1,000
Maj	7,500	1,000
Qershor	7,000	1,000
Korrik	7,000	1,000
Gusht	7,000	1,000
Shtator	8,000	1,000
Tetor	8,000	1,000
Nëntor	8,000	1,000
Dhjetor	8,000	1,000
Totali	87,500	13,000

Duke pasur për bazë numrin e rasteve te lidhjeve te reja qe kemi realizuar vitin e kaluar atëherë gjatë këtij viti planifikojmë të realizojmë pranimin e lidhjeve të reja sipas tabelës 4.

Tabela 4: Objektiva për lidhjet e reja në vitin 2024

2024	Lidhjet e reja
Janar	1,500
Shkurt	2,000
Mars	2,000
Prill	2,000
Maj	2,000
Qershor	2,000
Korrik	3,000
Gusht	3,000
Shtator	3,000
Tetor	3,000
Nëntor	2,000
Dhjetor	2,000
Total	27,500

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 11 prej 12
		Versioni	1.0

Duke pasur parasysh planifikimin e investimeve dhe realizimin e projekteve, Departamenti i Humbjeve ka planifikuar që gjatë këtij viti të bëjë ndërrimin dhe zhvendosjen e një numri te konsiderueshëm të njehsorëve (MMO - PLC - Smart). Te disa konsumatorë vërejmë se ka humbje të energjisë elektrike dhe nuk i lejohet qasja ekipeve te OSSH që të kryejnë punën zyrtare, si: (kontrollimi i sistemit matës, leximi i sistemit matës dhe shkyçja e njehsorit), atëherë te rastet e tilla kemi planifikuar të bëjmë instalimin e njehsorëve të mençur (*smart meter*), me anë të të cilëve realizohet komunikimi nga distanca me njehsorin (ku është edhe mundësia e kyçjes apo shkyçjes së njehsorit). Në trafo-stacionet 10/0.4 kV ku vërehet se ka humbje të konsiderueshme të energjisë elektrike, dhe ku pengohet puna zyrtare e ekipeve të OSSH-s, atëherë te rastet e tilla kemi planifikuar të bëjmë vendosjen e njehsorëve PLC me anë të të cilëve realizohet komunikimi nga distanca me njehsorin (ku është edhe mundësia e kyçjes apo shkyçjes së njehsorit). Për të arritur objektivat e lartpërmendura kemi planifikuar që me ekipet për kontrollimin e humbjeve të punojmë edhe me një orar fleksibil, ku kontrollimin e konsumatorëve komercial do ta bëjmë me orarin (12:00-20:00)h në sezonin dimëror dhe me orarin (14:00-22:00)h në sezonin veror, ky orar planifikohet të jetë sipas nevojës. Në tabelën 5 janë paraqitur të dhënat përbledhëse numerike të objektivave të lartpërmendura.

Tabela 5: Përbledhja e objektivave për ndërrimin e njehsorëve me PLC dhe lidhjet e reja

Muaji	Numri i njehsorëve me komunikim nga distanca (PLC)	Pranimet teknike të lidhjeve të reja (#)
Janar	2300	1,500
Shkurt	2200	2,000
Mars	2,400	2,000
Prill	2,400	2,000
Maj	2,700	2,000
Qershori	3,400	2,000
Korrik	3,200	3,000
Gusht	3,200	3,000
Shtator	3,200	3,000
Tetor	3,400	3,000
Nëntor	3,400	2,000
Dhjetor	3,200	2,000
Totali	35,000	27,500

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Faqe	Faqe 12 prej 12
		Versioni	1.0

## 5. PËRFUNDIM

Si përbledhje, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes planifikon të arrijë objektivat e lartpërmendura gjatë vitit 2024. Vlen të theksohet se edhe gjatë implementimit të projekteve në zhvendosjen e njehsorëve haset edhe në pengesa nga konsumatorët.

Edhe pse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes planifikon një sërë veprimesh për të zvogëluar dhe eliminuar humbjet jo teknike, duke përfshirë edhe metodat më koherente, përsëri sfida më e madhe do të jetë vështirësia për të parandaluar vjedhjet e përsëritura të energjisë elektrike, përfshi edhe konsumatorët që kyçen ilegalisht ne rrjet dhe nuk vazhdojnë me procedurat e regjistrimit. Kjo gjë nuk mund të parandalohet lehtë pa mbështetjen ligjore dhe institucionale.

Megjithatë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes synon qe humbjet ne fund te 2024 te jene 14.7 %, dhe ne tabelën ne vazhdim janë paraqitur parashikimi humbjet ne fund te 2023 (periudha Janar-Tetor sipas realizimi) dhe 2024 sipas distrikteve.

Tabela 6: Parashikimi i humbjeve sipas distrikteve për 2023 dhe 2024

Distrikti	Humbjet në fund të vitit 2023	Humbjet në fund të vitit 2024
DFE	14.99%	14.39%
DGJ	17.50%	16.80%
DGL	11.82%	11.35%
DMI	13.46%	12.93%
DPE	22.93%	22.02%
DPR	14.12%	13.56%
DPZ	14.80%	14.21%
Total	15.31%	14.70%